**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr. i Prokurimit:**KEK -26-1171-521**

Nr. i brendshëm:**KEKO- 26 - 160 -521**

Sa i përket tenderit për Aktivitetin e Prokurimit:
**Titulli: Riparimi dhe shtellimi(testimi) i valvave siguruese të kaldajes për bl.(A3-A5)**

**ANKESË**

1. **Identifikimi i ankuesit***

**UNIVERS – M SH.P.K.**
*Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj*

*Rruga Eqrem Qabej pn*
*Adresa*


*Rruga Eqrem Qabej pn Milloshevë – KK Obiliq* *15050*
*VendiKodi postar*

*044 276 071*
*(Numri Telefonit)Numri i Faks-it*

*TEFIK HARGAJA*
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

*e-mail: univers.m.pr@gmail.com*
*Adresa elektronike*

*Dt.18.11.2026*
*Data e parashtrimit të ankesësNënshkrimi dhe vula*



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____

*(Emri i avokatit)*

_____

*(Adresa e plotë)*

_____ _____

*(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)*

_____

*(Adresa elektronike)*

_____ _____

*(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

- Njoftimi per kontratë datë 06.05.2026
- Afati i fundit i dorezimit te tenderit datë 01.06.2026
- Kriteri i dhenjes se tenderit**Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët**☒

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

Eshte organizuar hapja publike e ofertave ne sistemin e E-prokurimit
Hapja e ofertave nëmenyre elektronike është bërë me dt.01.06.2026 , nuk kemi marrë pjesë në hapjen e tenderit.

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po [X] Jo [ ]

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*
*Me datë 30.10.2026 përmes platformës së e – Prokurimit kemi dërguar Kërkesen për Rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues – Korporata energjetike e Kosovës sh.a.*
*Me datë.09.11.2026 përmes platformës së e – Prokurimit AK ka derguar Përgjigjjen – Vendimin nga Autotoriteti Kontraktues dhe Kërkesën tonë për Rishqyrtim e konsideron si të pa bazuar.*

*Të pa kënaqur me këtë vendim të Autoritetit Kontraktues në afatin ligjore e dërgojmë Ankesën në OSHP.*

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosoves, me rastin e publikimit te njoftimit per Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës **27.10.2026** për **anulimin** e aktivitetit të prokurimit ***Riparimi dhe shtellimi (testimi) i valvave siguruese te kaldajes per bl(A3-A5)***,ka bere shkelje te dispozitave ligjore teLigjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (me tej: LPP), Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik (me tej: Rrpp), Udhëzuesit nr.001/2023 për Prokurimin Publik (me tej: Upp), te potencuara si vijon:

- *Eshte shkelur neni 1 i LPP-se,*
- *Eshte shkelur neni 7 i LPP-se,*
- *Eshte shkelur neni 56(1) i LPP-se*
- *Eshte shkelur neni 59 i LPP-se,*
- *Eshte shkelur neni 60.1(1.1) i LPP-se,*
- *Eshte shkelur neni 62 i LPP-se dhe neni 43.5 i Rrpp,*
- *Eshte shkelur neni 72 i LPP-se,*
- *Eshte shkelur neni 4.3 (a), (c), (e), (f), (g) i Rrpp,*
- *Eshte shkelur neni 25.5 i Rrpp,*
- *Eshte shkelur neni 40.6 (a), (b), (c) i Rrpp,*

*** Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Kompania : Univers – M shpk në Ankesë do të prezentojë faktet përmbajtësore për të argumentuar shkeljet ligjore të Autoritetit Kontraktues.
Autoriteti Kontraktues më dt.**27.10.2026** dërgon Njoftimin për Vendim të anulimit të kontrates publike në portalin e – prokurimit

Nëpërmjet këtij vendimi AK i ka prezentuar arsyet e anulimit :
**Rezultati i aktivitetit te prokurimit:**

Korporata Energjetike e Kosoves sh.a. **anulon** këtë aktivitet të prokurimit, pasi që asnjë ofertë nuk i plotëson kërkesat e dosjës së tenderit rrjedhimisht të gjitha ofertat janë të papërgjëgjshme.

Në Letren standarde per tenderuesin e eliminuar per Operatorin Ekonomik Univers – M shpk & ICI doo në njoftim thuhet se jeni eliminuar per shkak :

ARSYETIM:

Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye:
Nuk keni prezentuar staf të çertifikuar për operim me legatest, siç është kërkuar në dosjen e tenderit neni 9.1 & 9.2 pika 3 Kapaciteti teknik dhe profesional.

Me këtë arsyetim nuk pajtohet OE Univers – M shpk sepse i kemi përmbushur të gjitha kërkesat sipas dosjes së tenderit neni 9.1&9.2 pika 3 Kapaciteti teknik dhe profesional sepse :
Në ofertën e dorëzuar dt.01.06.2026 në :
**Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse:**
Në nr.**10** është dorëzuar: **Çertifikata e stafit të çertifikuar për operim me Legatest** dhe në këtë çertifikatë **është stafi i çertifikuar për operim me Legatest.**
**(Bashkangjitur : Dëshmia nr.1)**

Pas marrjes se njoftimit mbi vendimin e AK , kemi kërkuar nga AK qasje ne dokumente Autoriteti Kontraktues na e ka mundësuar qasjen me **dt.28.10.2026** në ora **13:45**

Gjate kontrollimit dhe verifikimit të dokementacionit të marrur nga qasja në ZEP me dt.**28.10.2026** kemi konstatuar se këtë aktivitet të prokurimit e kanë vleresuar **2(dy)** komisione vleresuese , **komisioni i vleresimit dhe komisioni i ri-vleresimit**

Në komisionin e vleresimit , data kur është pregaditur : Raporti i vlerësimit:**dt.07.07.2026** dhe përfunduar me dt.**29.07.2026** Komisioni vleresues ka rekomanduar për kontratë grupin e **OE Univers – M shpk & ICI doo** dhe në DEKLARATË thuhet : Komisioni i vleresimit pas ekzaminimit , vleresimit dhe krahasimit te tendereve per aktivitetin e prokurimit , konsideron se grupi i Operatoreve Ekonomik **Univers – M shpk & ICI doo** i plotëson të gjitha

kërkesat e dosjës së tenderit dhe si e tillë është ofertë e përgjëgjshme Raporti i vlerësimit është aprovuar nga ud Menaxheri për punë dhe shërbime dhe aprovuar nga ud Drejtori i ZEP -it në KEK
Në të njejtin Raport të vlerësimit në **faqe nr.13** nga **vet** AK më dt.**22.09.2026** është kërkuar që **lënda të kthehet në ri-vlerësim me qëllim të ri-shqyrtimit më detal te ofertave në të gjitha aspektet administrative, tekniko-profesionale , finaciare dhe specifikacionet teknik.**

Në komisionin e ri-vleresimit data kur është pregaditur :
**Raporti i ri- vlerësimit** dt. **22.10.2026** dhe komisioni i ri-vlerësimit e ka përfunduar vlerësimin mënjëherë pas **1(një) dite** me dt.**23.10.2026** dhe nga komisioni i ri-vlerësimit

në këtë DEKLARATË thuhet:
Komisioni i rivleresimit pas kontrollit dhe verifikimit të ofertave konkuruese si dhe tërë dokumentacionin tenderues , konstaton se asnjë ofertë nuk i plotëson kërkesat e dosjës së tenderit andaj **rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet.**

Me dt.27.10.2026 aprovohet rekomandimi i komisionit rivlerësues nga u.d.Drejtori i ZEP-it dhe me dt.27.10.2026 e kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK per anulimin e aktivitetit te prokurimit

Më këtë vendim nuk pajtohet OE ankues sepse i kemi përmbushur të gjitha kërkesat sipas dosjës së tenderit sipas nenit **9.1 & 9.2 pika 3 Kapaciteti teknik dhe profesional.**

Te gjitha pikat e **nenit 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional** pika 1 , pika 2 , pika 3 dhe pika 4 janë plotësuar nga OE dhe për **piken 3** kemi dorëzuar në ofertën tonë të dt.**01.06.2026** këto Çertifikata:

- Çertifikata e stafit të çertifikuar për operim me Legatest **(dëshmia nr.1)**
- Çertifikata për operim Ex Legatest për punë në ambiente eksplozive nga prodhuesi
- Çertifikaten ISO/IEC 17025 :2017 **Laborator i akreditуar për testimin dhe shtëllimin e paisjëve nën presion të lartë për - Valvat siguruese.**

**Legatesti** është instrument - paisje mobile me të cilin bëhët testimi dhe shtëllimi i valvave të sigurisë së lart me metoden kompjuterike në vendin ku janë të vendosura -montuara valvat siguruese në bl(A3-A5)

Në TC Kosova B në vitin 2025 dhe vitin 2026 ( bashkangjitur ofertes dt.01.06.2026 **Çertifikatat e pranimit te punëve nga AK** , dhe Raportet e testimit dhe shtellimit(me diagram me metoden kompjuterike) të valvave siguruese të testuara nga i **njejti staf i çertifikuar për operim me Legatest dhe nga i njejti punëkryerës i çertifikuar me të gjitha çertifikatat për riparimin dhe testimin(shtellimin) e valvave siguruese).**

Për valvat siguruese në **TC Kosova B** për bllokun **B1** dhe bllokun **B2** është kërkuar testimi dhe shtellimi i valvave siguruese me presion të lart deri në **350 bar** , kurse për valvat siguruese ne **TC Kosova A bl.(A3-A5)** kërkohet testimi dhe shtellimi i valvave siguruese me metoden kompjuterike me presion **nga 8 bar deri në 130 bar** sipas këtij aktiviteti të prokurimit në Aneksi 1 Specifikimet teknike te detyrueshme.

OE ankues kërkon nga AK **vetëm** vlërsimin e drejt të ofertave sipas kërkësave në dosjen e tenderit për të gjithë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit duke respektuar **Nenin 7 ( Barazia në Trajtim/Jo-diskriminimi)** sipas LPP-së dhe nenit **59 Ekzaminimi , vleresimi dhe krahasimi i tenderëve** sipas LPP -së

**Me date 09.11.2026 kemi pranuar Përgjigjen - Vendimin nga AK në Kërkesën për Rishqyrtim ku thuhet:**

. ANALIZA DHE SQARIMI NGA KOMISIONI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

| | |
|---|---|
| Sqarimi | **Përgjigja e Autoritetit Kontraktues**<br><br>Ne dosje te tenderit, ne nenin 9.1&9.2- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, është kërkuar shume kjarte: Kopje e certifikatës për operim me LEGATEST e prodhuesit dhe lista e stafit (personelit) të certifikuar nga laboratory për operim me LEGATESTIN<br><br>Ne dokumentin te cilin keni bashkangjitur dhe i referoheni ne kërkesën për rishqyrtim eshte dëshmia e certifikatës se kompanisë për operim me LEGATEST, por nuk jane ofruar dëshmitë per stafin e certifikuar per operim me LEGATEST<br><br>**Përfundim:**<br>Bazuar ne sqarimet e lartcekura, arsyetimi për eliminimin është i qëndrueshëm dhe i bazuar në fakte, me dokumentacionin e prezantuar nuk është plotësuar kërkesë e dhënë ne dosjes se tenderit - **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**. |

**Përgjigja e OE ankues për piken e eleminimit :**
Dokumentin të cilin e kemi bashkangjitur në Kërkesën për Rishqyrtim të dt.30.10.2026 është pikërisht Çertifikata e stafit(personelit) për operim me LEGATEST ku shumë kjartë në Çertifikatë së pari është vendosur emri dhe mbiemri i stafit(personelit) dhe pastaj nën emrin dhe mbiemrin e stafit(personelit) është vendosur emri i kompanisë ku është i punësuar stafi(personeli).

Çertifikimin e stafit (personelit) për operim me **LEGATEST** bëhët **vetëm** nga kompania :
**L- PLAN**
**(bashkangjitur dëshmia nr.1)**

Në Kërkesën për Rishqyrtim me të drejt kemi kërkuar nga AK **vetëm** vlërsimin e drejt të ofertave sipas kërkësave në dosjen e tenderit për të gjithë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit duke respektuar **Nenin 7 ( Barazia në Trajtim/Jo-diskriminimi)** sipas LPP-së dhe nenit **59 Ekzaminimi , vleresimi dhe krahasimi i tenderëve** sipas LPP -së

Mirëpo komisioni i rivlerësimit nga AK ka përdorur standarde të dyfishta në rivlerësim:

Në qasje në dokumentacion e dt.28.10.2026 për arsye se 2(dy) OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nuk kanë vazhduar validitetin e ofertes dhe vazhdimin e sigurimit të ofertës , në ZEP kemi pranuar vetëm dokumentacionin e ofertës për grupin e OE : B&D Engenering shpk : Specjalna oprema Lucko doo : Novamat shpk dhe në ofertën e këtij grupi të OE Çertifikata e stafit(personelit) është pikërisht e njejtë e lëshuar nga kompania: **L-PLAN** ku së pari në çertifikatë është vendosur emri dhe mbiemri i personit të stafit(personelit) dhe më posht është vendosur emri i kompanisë ku është i punësuar stafi(personeli).

Dhe çertifikata e stafit(personelit) e këtij grupi të OE është pranuar dhe nuk është eleminuar për këtë pikë nga komisioni i ri-vlersimit , kurse për të njejtën çertifikatë të stafit (personelit) e lëshuar nga kompania L-PLAN nga i njejti komision i rivlerësimit është eleminuar për këtë pikë OE ankues: Univers – M shpk, dhe në këtë rast komisioni i rivlersimit ka bërë shkelje ligjore të LPP-së
**(bashkangjitur dëshmia nr.2)**

Ne pajtim me argumentet ligjore dhe faktike te dëshmuara me prova materiale nepermjet kesaj Ankese( ju lutem, shih te bashkengjitur si pjese e perbashkete e kesaj Ankese) te gjitha faktet gjegjesisht provat e prezentuara qe deshmojne qarte shkeljet ligjore te Autoritetit Kontraktues.

Per cdo shoshitje/verifikim, vlerësim te argumenteve tona ligjore te prezentuara nepermjet fakteve te bashkengjitura, perfaqesuesit e Kompanise sone,jane te gatshem te ofrojne sqarime ligjore dhe teknike para OSHP-se ne fazen e Ankeses per te i mundesuar Autoritetit Kontraktues te konstatojene menyre te drejte, paaneshem, objektive dhe profesionale gjendjen faktike para marrjes se vendimit meritor.

## PROPOZIM

Duke marre parasysh argumentet, faktet, provat e potencuara dhe arsyetimet e ofruara me arsyetim ligjor dhe pretendimet per shkeljet e dipozitave ligjore te specifikuara ne piken 7 te kesaj Ankese firma "Univers – M "sh.p.k i propozon Panelit Shqyrtues në OSHP:

- Të aprovoje Ankesën si të bazuar të OE "Univers – M" sh.p.k.
- Të anuloj dokumentin B58 Njoftimin mbi vendimin e nxjerrë nga AK
- Lënden e kontestuar të kthejë në Rivlersim të ofertave duke propozuar për dhënje të kontrates ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ulet e cila plotëson kërkesat, kriteret e dosjes së tenderit sipas rregullave të LPP-së
- OE Univers – M shpk të vlerësohet i përgjegjshëm dhe të rekomandohet pë kontratë
- Të kthehet pagesa e tarifes- depozites konform rregullave në fuqi.

**9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Dëmet materiale janë të konsiderueshme në fushen financiare rreth pregaditjes se dosjes tenderuese , garancioni i ofertes , vazhdimin e garancionit te ofertes , fitime te munguara, mos mundesi te kompenzimeve te ketyre shpenzimeve pergaditore, kostos së përgaditjes së ankesave, stresit, shqetësimeve të shkatuar, kontratës se humbur në vlerë:159,536.00€ sipas rregullave ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

**10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*01.Datë :06.05.2026 "Njoftimit për Kontratë"*

*02.Datë :01.06.2026 Procesverbali i hapjes*

*03 Datë :07.07.2026 Raporti i komisionit te vleresimit te tenderit*

*04. Datë :22.10.2026 Raporti i komisionit te Ri-vleresimit te tenderit*

05.Datë :27.10.2026 Njoftimi mbi vendimin e AK – Anulimin e kontrates publike + LS

06.Datë:27.10.2026 Kerkese per qasje ne dokumente

07. Date:28.10.2026 Procesverbali nga qasja ne dokumente

*08.Datë:30.10.2026 Kerkesa per rishqyrtim ne AK*

09. Datë:09.11.2026 *Pergjigjja – Vendimi nga AK ne Kerkesen per rishqyrtim*

*10.Dëshmit nr.1 Çertifikata e stafit për operim me Legatest( grupi i OE Univers-M shpk & Ici doo)*

*11. Dëshmit nr.2 Çertifikata e stafit për operim me Legatest( grupi i OE B&D Engeniering : Specjalna oprema Lucko : Novamat shpk.*

*12.Dëshminë e pagesës ne përputhje me neni118 te LPP*

*Verejtje:Te gjitha pretendimet tona tona mbeshteten ne fakte bashkangjitur ankeses , materialin e të gjithe tenderueseve e gjeni ne proceduren e prokurimit per kete aktivitet te prokurimit ne Autoritetin Kontraktues – Korporaten Energjetike te Kosoves sh.a.*